

Në përgjigje të kërkesës në lidhje me ofrimin e shërbimit të hemodializës për shtetasit kosovarë që vijnë me qëndrim të përkohshëm në Shqipëri, ju informojmë si më poshtë vijon:

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ushtron veprimtarinë e tij në zbatim dhe në përputhje të ligjit nr. 10383 datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 308, datë 21.05.2014, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, i ndryshuar, Fondi financon paketat e shërbimeve shëndetësore në institucione shëndetësore publike dhe jo publike, në përputhje me kapacitetet e tyre për ofrimin e shërbimeve të paketave, duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. *Bazuar në urdhërin e Ministrisë të Shëndetësisë nr. 328, datë 01.08.2016 “Për ofrimin e shërbimit të dializës për shtetasit shqiptar me banim jashtë vendit dhe shtetasit e huaj, që vijnë me qëndrim të përkohshëm në Shqipëri”, pika 5, përcaktohet se:*

*Për shtetasit e huaj që vijnë me qëndrim të përkohshëm, për periudhën e qëndrimit në Shqipëri, shërbimi i dializës do të ofrohet kundrejt pagesë/seance, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, në paketën e shërbimit të dializës. Pagesa do të kryhet pranë Drejtorisë Rajonale të FSDKSH-së, e cila mbulon qendrën e dializës, ku të sëmurit i ofrohet shërbimi.*

Për sa më sipër, shprehemi se Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, financon shërbime të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.